



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2022:222315 **C. nr. 3700/2022**  
Datë: 20.12.2022  
Numri i dokumentit: 03776664

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – gjykatësi Atdhe Berisha, me praktikantin D.M. në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditëses: B.B. nga fshati .... Komuna e Prizrenit, te cilin me autorizim e përfaqëson Av.D.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “.....” me seli në Prishtinë, jashtë seance, me datë 20 dhjetorë 2022 , morri këtë:

A K T V E N D I M

Konstatohet e tërhequr padia në këtë çështje kontestimore.

A r s y e t i m

Pranë Gjykatës Themelore në Prizren, është iniciuar procedura kontestimore, sipas padisë së paditëses: B.B. te cilin me autorizim e përfaqëson Av.D.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “.....” me seli në Prishtinë, në çështjen kontestimore kompensim dëmi.

I autorizuari i paditësit me parashtresën e datës 15 dhjetorë 2022 , ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë në këtë çështje kontestimore, lidhur me këtë çështje kontestimore, dhe mbi këtë bazë në mungesë të interesit juridik për vazhdim të ndjekjes së çështjes përmes Gjykatës e bëjmë tërheqjen e padisë.

Pasi që pala paditëse ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë në këtë çështje kontestimore, gjykata në kuptim të nenit 261 të LPK-së, vendosi që të konstatohet se padia është tërhequr.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
C. nr. 3700/2022 datë 20 Dhjetorë 2022

Praktikanti  
Denis Muhaxheri

Gj y k a t ë s i  
Atdhe Berisha

**UDHËZIME PËR ANKESË:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.